



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 614/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Kamenicë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhorë (KKZ) dega në Kamenicë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pas afatshme ankesa e Aleancës Kosova e Re (AKR) dega në Kamenicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga AKR me datë 05.11.2013, në ora 21:10 në të cilën ka pretenduar se, në Kamenicë fletëvotimet të cilat janë të evidentuara në tre procesverbalet e datës 03.11.2013 janë dërguar në vendvotime pa përcjelljen e pjesëtarëve të policisë së Kosovës. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur tri procesverbale të datave 03.11.2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pas afatshme

Me ankesën e parashtruar nga AKR-ja ka pretenduar se, fletëvotimet e evidentuara sipas procesverbaleve janë dërguar në vendvotime pa përcjelljen e policisë së Kosovës.

PZAP-i pasi shqyrtoi ankesën konstatoi se, ankesa është e pas afatshme pasi që, nga shkelja e supozuar ankesa nuk është dorëzuar në afatin e rregullt ligjorë deri më datë 04.11.2013 në ora 19:00, që nënkupton se e njëjta është dorëzuar një ditë pas afatit, andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 614/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*